Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
Nr/Br. 280-300/20
Data/Datum. 12.06.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

PSH.nr.280/20
300/20

PANELI SHQYRTUES,i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042,i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068,dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të: z. Blerim Dina - Kryetar, z. Nuhi Paçarizi - Referues, z. Goran Milenković – Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: OE "PAPERBURG&ADRIANI COMPANY Sh.p.k& Companya ESKAVATORI Sh.p.k & Best Company Sh.p.k-Ferizaj si dhe ankesës së OE "2A Group & 2T Shpk"-Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik:" "GËRLICA - COMPANY" SH.P.K-Ferizaj, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull:"Asfaltimi i rrugës Pleshinë-Kashtanjeve të Ferizajt-projekt tre vjeçar", me nr. të prok: 656-17-3827-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna Ferizaj, më datën:11.06.2020,mori këtë:

V E N D I M

I.<u>HEDHEN,</u> si të pa lejuara ankesat e operatorit ekonomik: "PAPERBURG&ADRIANI COMPANYSh.p.k&Companya ESKAVATORI Sh.p.k& Best Company Sh.p.k-Ferizaj, dhe ankesa e operatorit ekonomik "2A Group & 2T Shpk"-Prishtinë, si palë pa interes juridik material konform nenit 4 paragrafi 1.26 i LPP-së, përkitazi me nenin 111 paragrafi 1-8 i LPP-së, pasi që në asnjë mënyrë këta OE ankues nuk kanë mundur të dëshmojnë se shkelja e supozuar iu është kërcënuar t'iu shkaktojë dëme dhe njëkohësisht me këto rrethana dhe fakte, të njëjtit në asnjë variant nuk kanë mundur të shpallen fitues i këtij tenderi, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Asfaltimi i rrugës Pleshinë-Kashtanjeve të Ferizajt-projekt tre vjeçar", me nr. të prok: 656-17-3827-5-1-1, të iniciuar nga AK-KK Ferizaj.

II.<u>VËRTETOHET,</u> njoftimi për dhënien të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me :"Asfaltimi i rrugës Pleshinë-Kashtanjeve të Ferizajt-projekt tre vjeçar", me nr. të prok: 656-17-3827-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna Ferizaj.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 15 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues ekonomik "PAPERBURG&ADRIANI COMPANY Sh.p.k& Companya ESKAVATORI Sh.p.k& Best Company Sh.p.k-Ferizaj, dhe ankesa e operatorit ekonomik ankues 2A Group & 2T Shpk"-Prishtinë hedhen si te pa lejuara, iu bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI .Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues OE "PAPERBURG&ADRIANI COMPANY Sh.p.k & Companya ESKAVATORI Sh.p.k & Best Company Sh.p.k-Ferizaj si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 07.05.2020 me nr. 280/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: :"Asfaltimi i rrugës Pleshinë-Kashtanjeve të Ferizajt-projekt tre vjeçar", me nr. të prok: 656-17-3827-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna Ferizaj.,duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet: 7 dhe nenin 13 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Operatori ekonomik ankues "2A Group & 2T Shpk"-Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 14.05.2020 me nr. 300/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: :"Asfaltimi i rrugës Pleshinë-Kashtanjeve të Ferizajt-projekt tre vjeçar", me nr. të prok: 656-17-3827-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna Ferizaj.,duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet: 1, 6, 7, 59, 60 dhe nenin 69 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit,konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë:18.05.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtuesi prokurimit në raportin e dt: 28.05.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

Tenderuesi ankues, Grup i OE: "Companya Eskavatori" Sh.p.k.& KNPSH. "PAPENBURG & ADRIANI COMPANY" Sh.p.k. & "Best Company" SH.P.K. Magjis. Ferizaj – Prishtinë, Ferizaj, deklaron se Nuk pajtohet me Njoftimin mbi vendimin e publikuar nga AK- KOMUNA FERIZAJ të datë 24.04.2020. dhe PRETENDON se AK ka bërë gabim gjate vlerësimit të tenderit. Dispozitat e shkelura të LPP-së, sipas tenderuesit ankues, nga ana e Autoriteti Kontraktues, janë: Neni 7, Barazia në trajtim/Jo diskriminimi Neni 13, Përdorimi i gjuhëve në dokumentet e prokurimit publik Eksperti shqyrtues pas ekzaminimit të tenderit dhe rrjedhës së procedurës së vlerësimit dhe pretendimeve të palës ankuese në ankesë, duke u bazuar ne shkresat e lendes se trajtuar sqaron me sa vijon: Përgjigje në pretendimin e lartë cekur (Neni 7) Eksperti shqyrtues, konstaton se ky pretendim i tenderuesit ankues, (Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi) është i pabazuar, sepse me rastin e kontrollimit të Dosjes së tenderit, Njoftimit për Kontratë dhe dokumentacionin të dorëzuar me tender, gjatë procesit të vlerësimit, Autoriteti Kontraktues e ka shpallur fitues tenderuesin e përgjegjshëm, që është në pajtim me Nenin 60 të LPP, Autoriteti kontraktues do t'ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar: 1.1 tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët; Autoriteti Kontraktues me rastin e shpalljes së Tenderuesit "GËRLICA - COMPANY" SH. P.K., Babush P.N., Ferizaj, fitues për këtë kontratë nuk ka bërë shkelje të nenit 7 të LPP- së, nuk ka bërë kurrfarë favorizimi të ofertës së këtij operatori i cili sipas vlerësimit nga ana ime është i përgjegjshëm dhe nuk ka diskriminuar operatoret tjerë pjesëmarrës në tender e në këtë rast as Tenderuesi ankues, Grup i OE: "Companya Eskavatori" Sh.p.k.& KNPSH. "PAPENBURG & ADRIANI COMPANY" Sh.p.k. & "Best Company" SH.P.K. Magjis. Ferizaj – Prishtinë, Ferizaj, i cili e ka ofertën më të lartë për 749,512.30 €.

Përgjigje në pretendimin e lartë cekur (Neni 13- Përdorimi i gjuhëve në dokumentet e prokurimit publik) Eksperti shqyrtues, konstaton se pretendim i tenderuesit ankues, se janë bërë shkelje të Nenit 13 të LPP-së, është i pabazuar, sepse duke u bazuar në dokumentacionin e prezantuar që kam shqyrtuar, Autoriteti Kontraktues e ka bërë Ekzaminimin, Vlerësimin e Tenderit, në pajtim me neni 59 par. 4 të LPP-së, po citoj: "Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit". Tenderuesi ankues, pretendon se tenderuesi i shpallur fitues nuk i ka plotësuar Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, Neni 9.1. & 9.2 nga Seksioni II. FLETA E TË DHENAVE të Tenderit (FTD),

faqe 12-13 të DT: Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2 Kapaciteti teknik dhe profesional: 2. Stafi profesional: b. Një gjeodet te licencum

Dëshmia e kërkuar dokumentare: b. Një gjeodet, të argumentuar me licence valide. Licenca dhe diploma duhet te ofrohen kopje te vërtetuara. Eksperti shqyrtues në bazë të dokumentacionin të dorëzuar me ofertë-tender ka konstatuar, se nuk qëndron pretendimi i tenderuesit ankues, se autoriteti kontraktues gjatë vlerësimit të tenderit të fituesit "GËRLICA - COMPANY" SH. P.K., Babush P.N., Ferizaj, pa të drejtë e ka shpallë të përgjegjshëm te kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale, pasi që për gjeodetin e licensuar ka ofruar diplomën universitare në gjuhë Maqedonase, të z. Zekirja Elezi. Autoriteti Kontraktues me qëllim të respektimit të Vendimit të OSHP – së me numër: PSH. 769/19, 778/19 dhe 792/19 me datë 23.12.2019 dhe bazuar në nenin 59 pika 4 dhe 72 të LPP-ës pika 2, me rastin e Rivlerësimit të këtij aktiviteti të prokurimit ka kërkuar sqarime plotësuese nga tenderuesi "GËRLICA - COMPANY" SH. P.K., Babush P.N., Ferizaj, për gjeodetin e licencuar të z. Zekirja Elezi , përkthimin e diplomës së dorëzuar universitare në gjuhë Maqedonase, në një nga gjuhët zyrtare (në gjuhën Shqipe, Serbe ose në gjuhën Angleze. Lidhur me rastin e paraqitur në këtë tender, AK me datë 04.01.2020 ka marrë interpretim nga KRPP-ja, Po i njejti interpretim Ligjor edhe nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik te INFORMACIONE / PYETJE TË SHPESHTA, lidhur me këto raste (pyetja dhe përgjigjja 66) në mes tjerash ka dhënë opinionin si vijon:

Për veç tenderi, i cili ofron specifikimet teknike në gjuhë tjetër nga ajo e përcaktuar me LPP, duhet të përjashtohet, ndërsa për cilindo dokument tjetër të kërkuar si dëshmi sipas nenit 65-71 të LPP-së, në përputhje me nenin 72 të LPP-së mund të kërkohet nga OE që të dorëzojë një përkthim zyrtar të të njëjtit dokument. Sigurimi i informacionit që mungon ose ofrimi i i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderit dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive. Meqenëse tenderuesi i rekomanduar për kontrate "GËRLICA - COMPANY" SH. P.K., Babush P.N., Ferizaj, në lidhje me këtë çështje, me dt. 26.11.2019 ka dorëzuar ne OSHP, një parashtrese si sqarim ne lidhje me ketë pretendim, ku kësaj parashtrese ja ka bashkangjitur diplomat) me përkthim origjinal te përkthyer nga përkthyesi gjyqësor z.Afrim Sejdini me dt. 05.06.2017, andaj, eksperti shqyrtues këto sqarime dhe dëshmi shtesë (përkthimi i diplomës në gjuhën shqipe, licencën e vazhduar) të cilat AK gjatë rivlerësimit i ka pranua nga tenderuesi i shpallur fitues , i kamë vërtetua dhe janë pjesë e tenderit dhe shtojcë e këtij raporti. Prandaj vlerësojë se AK nuk janë bërë shkelje të neni 13, sepse sqarimet dhe dëshmitë gjatë rivlerësimi janë bërë në pajtueshmëri me nenin 59 pika 4 dhe 72 të LPP-ës pika 2, për vlerësimin e Kërkesave mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, neni 69 i LPP-së. Ndërsa sa i përket pretendimit te OE ankues Konzorciumit KNPSH "PAPENBURG & ADRIANI COMAPNY Sh.p.k & Companya ESKAVATORI Sh.p.k &Best Company Sh.p.k- Ferizaj, se diploma e

gjeodetit te OE te rekomanduar për kontrate është e pa nostrifikuar, eksperti shqyrtues sqaron se nostrifikimi i diplomave nuk ka qenë kërkesë e FDT, prandaj sipas nenit 56.3 te LPP, operatoret ekonomik nuk mund te eliminohen për një kërkesë e cila nuk ka qene kërkesë e dosjes s tenderit dhe e njoftimit për kontrate, citojmë nenin 56.3 te LPP-së : Tenderuesi, gjate procedurave te hapura, ose kandidati, gjate procedurave te kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do te diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla ne baza te ndonjë kërkesë ose kriteri qe nuk është i cekur ne njoftimin e kontratës dhe ne dosjen e tenderit. Pas këtyre argumenteve të prezantuara përmes këtij raporti, për pretendimet e Tenderuesi ankues, Grup i OE: "Companya Eskavatori" Sh.p.k.& KNPSH. "PAPENBURG & ADRIANI COMPANY" Sh.p.k. & "Best Company" SH.P.K. Magjis. Ferizaj – Prishtinë, Ferizaj, eksperti shqyrtues vlerëson se andaj AK me të drejtë dhe me arsye e ka kualifikuar të përgjegjshëm dhe e ka shpallur fitues tenderin e tenderuesit "GËRLICA - COMPANY" SH. P.K., Babush P.N., Ferizaj.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e Tenderuesit ankues të refuzohet e pabazuar, njëherësh propozoj që të aprovohet Vendimi i Autoritetit Kontraktues për dhënie të kontratës dhe të vazhdojë sipas dispozitave të LPP-së, për aktivitetin e prokurimit me titull: "Asfaltimi i rrugës Pleshine-Kashtanjeve te Ferizajt-projekt tre vjeçar" me nr. të prokurimit: 656-17-3827-511, dhe numër të brendshëm : 656-17-115-511, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA FERIZAJ.

Tenderuesi Ankues, (Grup i OE: "2A Group" shpk. & "2T"shpk, Prishtinë), deklaron se Nuk pajtohet me Njoftimin mbi vendimin e publikuar nga AK- KOMUNA FERIZAJ të datë 24.04.2020 dhe PRETENDON se AK ka bërë gabim gjate rivlerësimit të tenderit. Dispozitat e shkelura të LPP-së, sipas tenderuesit ankues, nga ana e Autoriteti Kontraktues, janë:

Neni 1, Qëllimi

Neni 6 - Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 7, Barazia në trajtim/Jo diskriminimi

Neni 60, Kriteret pre Dhënien e Kontratës

Neni 69, Aftësia Teknike dhe/ ose Profesionale

Neni 59, Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i tenderëve

Eksperti shqyrtues pas ekzaminimit të tenderit dhe rrjedhës së procedurës së ri vlerësimit dhe pretendimeve të palës ankuese në ankesë, duke u bazuar ne shkresat e lendes se trajtuar sqaron me sa vijon:

Përgjigje në pretendimin e lartë cekur (Neni 1)

Eksperti shqyrtues, konstaton se ky pretendim i tenderuesit ankues, (Qëllimi) është i bazuar, sepse me rastin e kontrollimit të Dosjes së tenderit, Njoftimit për Kontratë dhe dokumentacionin të dorëzuar me

tender, gjatë procesit të vlerësimit, Autoriteti Kontraktues, pa të drejtë e ka eliminuar Tenderuesi Ankues, (Grup i OE: "2A Group" shpk. & "2T"shpk, Prishtinë) sepse nga kontrollimi i referencave të dorëzuara, ankuesi është i përgjegjshëm dhe i ka plotësuar Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale. Tenderuesi ankues ka dorëzuar tenderin e përgjegjshëm me çmim më të ulët, prej 3,147,049.00 €, kurse Autoriteti Kontraktues e ka shpallur fitues tenderuesin e papërgjegjshëm "GËRLICA - COMPANY" SH. P.K., Babush P.N., Ferizaj, i cili është më çmim më të lartë për 102,975.80 €, pasi oferta tij është me çmim prej 3,250,024.80 €, andaj me ky veprim gjatë vlerësimit nuk është në pajtueshmëri me Nenin 1 të LPP-së, sepse citojmë :

1. Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla.

2. Ky ligj gjithashtu ka për qëllim të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji. 3. Ky ligj ka për qëllim të nxisë krijimin e një kulture institucionale të profesionalizuar të pandikuar nga interesat materiale, të paanshme, etike, në mesin e personave zyrtarë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit, duke kërkuar nga personat e tillë që të sjellën duke ndjekur parimin e shfrytëzimit sa më efikas, me kosto ekonomike, transparent dhe të drejtë të fondeve dhe burimeve publike ndërkaq duke iu përmbajtur rreptësishtë procedurave dhe kushteve qenësore të këtij ligji.

Përgjigje në pretendimin e lartë cekur (Neni 6).

Eksperti shqyrtues, konstaton se ky pretendim i tenderuesit ankues, (Ekonomiciteti dhe Efikasiteti) është i bazuar, sepse me rastin e kontrollimit të Dosjes së tenderit, Njoftimit për Kontratë dhe dokumentacionin të dorëzuar me tender, gjatë procesit të rivlerësimit, Autoriteti Kontraktues me shpalljen e tenderusit fitues, tenderuesin "GËRLICA - COMPANY" SH. P.K., Babush P.N., Ferizaj, që është me çmim më i shtrenjte se tenderuesi ankues (Grup i OE: "2A Group" shpk. & "2T"shpk, Prishtinë), nuk ka dëshmuar se këtë proces e ka udhëhequr në pajtim me parimet bazike Efikasiteti & Efektiviteti, për Nenin 6 pika 1. të LPP-së, sepse citojmë : 1. Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe

burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit Përgjigje në pretendimin e lartë cekur (Neni 7) Eksperti shqyrtues, konstaton se ky pretendim i tenderuesit ankues, (Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi) është i bazuar, sepse me rastin e kontrollimit të Dosjes së tenderit, Njoftimit për Kontratë dhe dokumentacionin të dorëzuar me tender, gjatë procesit të rivlerësimit, Autoriteti Kontraktues e ka shpallur fitues tenderuesin me çmimin 3,250,024.80 € "GËRLICA - COMPANY" SH. P.K., Babush P.N., Ferizaj, që është me çmim më i shtrenjte për 102,975.80 €, se tenderuesi ankues, Grup i OE: "2A Group" shpk. & "2T"shpk, Prishtinë, i cili ka ofruar çmimin 3,147,049.00. Autoriteti Kontraktues me rastin e shpalljes fitues për këtë kontratë të Tenderuesit "GËRLICA - COMPANY" SH. P.K., Babush P.N., ka bërë shkelje të nenit 7 të LPP- së, duke favorizuar ofertën e këtij operatori, i cili ka dorëzuar ofertë me çmim më të lartë se tenderuesi ankues, andaj AK duke mos u trajtuar në mënyrë të barabartë, ka bërë diskriminim ndaj tenderuesit ankues, Grup i OE: "2A Group" shpk. & "2T"shpk, Prishtinë, i cili ka dorëzuar tenderin e përgjegjshëm me çmim më të ulët prej 3,147,049.00 €.

Përgjigje në pretendimin e lartë cekur (Neni 60, Kriteret për Dhënien e Kontratës)

Eksperti shqyrtues, konstaton se ky pretendim i tenderuesit ankues, se nuk është zbatuar si duhet Nenin 60 të LPP-së me rastin e rivlerësimit të tenderëve (Kriteret për Dhënien e Kontratës) është i bazuar, sepse nuk është respektuar ky nen, ku kërkohet (citojmë) :

LPP ne nenin 60 paragrafi 1. dhe nen paragrafin 1.1 përcakton: 1. Autoriteti kontraktues do t'ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar ose: 1.1 tenderin ë përgjegjshëm me çmimin më të ulët: 2. Duke u bazuar ne fakte te prezantuar ne dokumentacionin qe kam shqyrtuar, analizuar dhe krahasuar dhe në atë që u tha më lartë në këtë raport, Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar ne pajtueshmëri me nenin 60, duke e shpallur fitues tenderuesin e "GËRLICA - COMPANY" SH. P.K., Babush P.N., Ferizaj, sepse e ka propozuar që t'ia jap kontratën publike tenderuesit që ka dorëzuar tenderin ë përgjegjshëm me çmimin më të lartë se ankuesi. Përgjigje në pretendimin e lartë cekur (Neni 59) Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve Eksperti shqyrtues, konstaton se ky pretendim i tenderuesit ankues, është i bazuar, sepse duke u bazuar në rrjedhën e këtij aktiviteti të prokurimit të prezantuar në dokumentacionin që kam shqyrtuar, Autoriteti Kontraktues nuk e ka bërë Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve, në pajtim me neni 59 par. 4 të LPP-së, po citoj: "Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit".

Eksperti shqyrtues, me rastin e kontrollimit të dokumentacionin të dorëzuar me ofertë-tender, vlerësimi i Autoriteti Kontraktues se : OE nuk ka ofruar deklaratën nën betim për marrëveshjen e konzorciumit që të tregoni që është ende valide ashtu siç është kërkuar nga komisioni për rivlerësime dokumenteve të projektit

në fjalë me shkresën e datës 06.04.2020, ky arsyetim nuk qëndron, sepse dokumentacioni i dorëzuar për këtë tender është dorëzuar në pajtueshmëri me afatin para datës së publikimit të Njoftimit për Kontratë dhe nuk mund të ndryshohen pas hapjes së tenderëve, sepse bijën në kundërshtim me LPP. Meqenëse pjesëmarrja e tenderuesit ankues është pjesëmarrje në Grup të Operatorëve ekonomik, ky tenderues gjatë kësaj periudhe te gjatë të vlerësimit, ka ofruar vazhdimin e validitetit të ofertës në emër të konzorciumit, me çka është nënkuptuar se kjo marrëveshje është ende valide.

Eksperti shqyrtues, me rastin e kontrollimit të dokumentacionin të dorëzuar me ofertë-tender, vlerësimi i Autoriteti Kontraktues se : OE nuk ka ofruar kontratë valide të inxhinierit të ndërtimtarisë ashtu siç është kërkuar për vazhdimin të kësaj kontrate ku e njëjta kontratë ka skaduar në vitin 2019, ky arsyetim nuk qëndron, sepse dokumentacioni i dorëzuar për inxhinierin e ndërtimtarisë është dorëzuar në pajtueshmëri me afatin para datës së publikimit të Njoftimit për Kontratë.

Vlerësoj se Autoriteti kontraktues gjatë rivlerësimit të këtij aktiviteti të prokurimit pa të drejtë e ka eliminuar Tenderuesin Ankues (Grup i OE: "2A Group" shpk. & "2T"shpk, Prishtinë), në bazë të një kërkese që nuk është cekur dhe kërkuar në njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit andaj ky pretendim i ankuesit se rivlerësimi nuk është bërë në pajtueshmëri me Nenin 59 të LPP-së është i qëndrueshëm. Autoriteti kontraktues me këtë rast ka bërë shkelje edhe të nenit 56 paragrafi 3 i LPP-së, sipas të cilit citoj :

1. Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkese ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Përgjigje në pretendimin e lartë cekur (Neni 69) Aftësia Teknike dhe/ ose Profesionale. 1. Eksperti shqyrtues, konstaton se pretendim i tenderuesit ankues, është i bazuar, sepse duke u bazuar në dokumentacionin e prezantuar që kam shqyrtuar, Autoriteti Kontraktues nuk e ka bërë Ekzaminimin, Vlerësimin e Tenderit, në pajtim me neni 59 par. 4 të LPP-së, po citoj: "Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit". Tenderuesi ankues, i ka plotësuar Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, Neni 9.1. & 9.2 nga Seksioni II. FLETA E TË DHENAVE të Tenderit (FTD), faqe 12-13 të DT: Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2 Kapaciteti teknik dhe profesional:

1. Operatori ekonomik duhet te ofroje një vlere jo me pak se 4,000,000.00 € ne lidhje me punët e ngjashme ne tri vitet e fundit (2014-2016) Dëshmia e kërkuar dokumentare: 1. Lista e kontratave (e nënshkruar dhe e vulosur), operatori ekonomik duhet te ofroj listën e kontratave te realizuara gjate tri viteve te fundit ne origjinal, te nënshkruar dhe vulosur nga OE, te dëshmuar me referenca ose pranime teknike te punëve , te kryera ne lëmin e ndërtimit dhe punëve te ngjashme, te cilat tregojnë vlerën, datën, llojin dhe vendin e

projektit punues ose aktiviteteve te ndërtimit / certifikatë e pranimit. Eksperti shqyrtues, me rastin e kontrollimit të dokumentacionin të dorëzuar me ofertë-tender, konstaton se shuma e dëshmive –me referenca ose pranime teknike te punëve, te kryera ne lëmin e ndërtimit dhe punëve te ngjashme, te cilat tregojnë vlerën, datën, llojin dhe vendin e projektit punues ose aktiviteteve te ndërtimit / certifikatë e pranimit, për këtë tender, ne lidhje me punët e ngjashme ne tri vitet e fundit (2014-2016) e tejkalojnë shumën minimale 4,000,000.00 €. Ky realizim i punët e ngjashme ne tri vitet e fundit (2014-2016) i tenderuesit ankues është argumentuar me dëshmi shtesë : kontratat, nga marrëveshjet e nën kontraktimit, me referencat dhe certifikatat e pranimi teknik, por i janë bashkangjitur shtojce edhe faturat me shumat e realizuara ne vitin 2014, 2015 dhe 2016 që të gjitha e tejkalojnë shumën minimale dhe janë 9,960,246.36 €, si në tabelën në vijim:

Nr.	Titulli i Kontratës	Data e nënshkrimit te kontratës dhe mbarimit te kontratës		Data e dokumentit	Vlera e realizuar e kontratave (Lekë)	Vlera e realizuar e kontratës në (Euro)
1	"Rikonstruimi i rrugës Hani I Hotit Tamare" me nr. Kontrate CWC/ICB/2010/WL-Rec 46 e kontraktuar me dt.11.01.2013	11.01.2013 përfunduar me dt. 31.07.2014, me certifikatë pranimi teknik me dt. 15.10.2014	Fatura nr. 175	31.01.2014	18,499,440.00	
			Fatura nr. 177	28.02.2014	42,124,800.00	
			Fatura nr. 193	30.06.2014	33,732,360.00	
			Fatura nr. 198	31.07.2014	61,023,940.00	
			Fatura nr. 206	25.11.2014	120,018,005.00	
			Fatura nr. 212	30.12.2014	48,146,400.00	
	Gjithsej :	pjesemarrja 40%			**323,544,945.00**	**2,563,288.48**
2	"Rikonstruimi i rrugës lidhëse Farka me rrugën Elbasan" me nr. Kontrate CWC/ICB/2013/WL-Rec 137	27.05.2013, përfunduar me dt. 19.04.2014, me certifikatë pranimi teknik me dt. 26.02.2015	Fatura nr. 182	31.03.2014	18,842,784.00	
			Fatura nr. 187	05.05.2014	17,524,042.00	
			Fatura nr. 193	30.06.2014	9,722,040.00	
			Fatura nr. 191	30.06.2014	20,011,332.00	
			Fatura nr. 204	09.10.2014	40,444,179.00	
			Fatura nr. 221	27.02.2015	18,864,000.00	
			Fatura nr. 223	19.03.2015	22,943,899.00	
			Fatura nr. 243	10.08.2015	13,900,178.00	
	Gjithsej :	pjesemarrja 60%			**162,252,454.00**	**1,285,446.90**
3	"Ndërtimi i rrugës Grabom-BCB me Malin e Zi" me nr. Kontrate 2015/363- 326 dhe 2015/363-619	27.07.2015, përfunduar me dt. 05.10.2016, me certifikatë pranimi teknik me dt. 27.10.2016	Fatura nr. 448	28.06.2016	32,839,346.45	239,371.28
			Fatura nr. 208	21.11.2016	101,668,676.70	747,838.74
	Gjithsej :				**134,508,023.15**	**987,210.02**
4	Punime per ndertimin e Bypass-it twe Rrogozhines, Nr kontrates :2013/332-861 Numer identifikues : EuropeAid/134340/C/WKS/AL	punimet e realizuara - referenca me dt. 15.02.2016	30 % e kontrates 5,689,855.55 Euro			**1,706,956.67**

5	"Rikonstruimi i rrugës Vagarr-Gropaj-Kthesa e Kashari" me nr. Kontrate CWC/ICB/201/WL-Rec 94 e kontraktuar me dt.11.01.2013	11.01.2013 përfunduar me dt. 31.07.2014, me certifikatë pranimi teknik me dt. 15.10.2014				**2,014,600.40**
6	"Ndertimi i rrugës Regjionale R211,segmenti Osojan-Rakosh-Kryqezimi me rrugën R101,L-8041km,K Istog" me nr. Kontrate MI/15/012/511 e kontraktuar me dt.23.07.2015	23.07.2015 përfunduar me dt. 09.2016, me raport pranimi teknik me dt. 04.10.2016				**1,402,743.89**
	Totali:					**9,960,246.36**

Eksperti shqyrtues në bazë të dokumentacionin të dorëzuar me ofertë-tender dhe me sqarimet shtesë gjatë kohës së rivlerësimit ka konstatuar se Projektet-punët e kryera janë te realizuara dhe tejkalojnë vlerën e kërkuar në tre vitet, si është kërkuar 2014-2016.

Pas këtyre argumenteve të prezantuara përmes këtij raporti, eksperti shqyrtues vlerëson se janë bërë shkelje të neni 69 (*Aftësia Teknike dhe/ ose Profesionale*)sepse vlerësimi nuk është bërë në pajtueshmëri këtë nen të LPP-së dhe nenin 59 të LPP-së.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e Tenderuesit ankues **aprovohet e bazuar**, njëherësh propozoj që të **anulohet Vendimi i Autoritetit Kontraktues** për dhënie të kontratës, për aktivitetin e prokurimit me titull: "Asfaltimi i rrugës Pleshine-Kashtanjeve te Ferizajt-projekt tre vjeçar" me nr. të prokurimit: 656-17-3827-511, dhe numër të brendshëm : 656-17-115-511**,** iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA FERIZAJ dhe rekomandon që lënda të kthehet në **rivlerësim**.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 02.06.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik "2A Group & 2T Shpk"-Prishtinë, me datë: 01.06.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik "PAPERBURG&ADRIANICOMPANSh.p.k&Companya ESKAVATORI Sh.p.k & Best Company Sh.p.k-Ferizaj, me datë: 21.05.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 11.06.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit, dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Paneli shqyrtues duke u bazuar në të gjitha dëshmitë dhe argumentet përkatëse si dhe duke u bazuar në konstatimet e ekspertes shqyrtuese, sqaron se pretendim i OE ankues "PAPERBURG & ADRIANI COMPANY Sh.p.k & Companya ESKAVATORI Sh.p.k & Best Company Sh.p.k-Ferizaj është se është shkelur Neni 13 i LPP-së - Përdorimi i gjuhëve në dokumentet e prokurimit publik, për shkak se tenderuesi i shpallur fitues nuk i ka plotësuar Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, Neni 9.1. & 9.2 nga Seksioni II. FLETA E TË DHENAVE të Tenderit (FTD), faqe 12-13 të DT: Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2 Kapaciteti teknik dhe profesional: 2. Stafi profesional: b. Një gjeodet te licencum

Dëshmia e kërkuar dokumentare: b. Një gjeodet, të argumentuar me licence valide. Licenca dhe diploma duhet te ofrohen kopje te vërtetuara.

Lidhur me pretendimin lartpërmendur. Paneli shqyrtues ashtu siq e ka cekur edhe ekspertja shqyrtuese ka konstatuar, se nuk qëndron pretendimi i tenderuesit ankues, se autoriteti kontraktues gjatë vlerësimit të tenderit të fituesit "GËRLICA - COMPANY" SH. P.K., Babush P.N., Ferizaj, pa të drejtë e ka shpallë të përgjegjshëm te kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale, pasi që për gjeodetin e licencuar, i njëjti ka ofruar diplomën universitare në gjuhë Maqedonase, të z. Zekirja Elezi. Autoriteti Kontraktues me qëllim të respektimit të Vendimit të OSHP – së me numër: PSH. 769/19, 778/19 dhe 792/19 me datë 23.12.2019 dhe bazuar në nenin 59 pika 2 dhe 72 të LPP-ës pika 2, me rastin e Rivlerësimit të këtij aktiviteti të prokurimit ka kërkuar sqarime plotësuese nga tenderuesi "GËRLICA - COMPANY" SH. P.K., Babush P.N., Ferizaj, për gjeodetin e licencuar të z. Zekirja Elezi, përkthimin e diplomës së dorëzuar universitare në gjuhë Maqedonase, në një nga gjuhët zyrtare (në gjuhën Shqipe, Serbe ose në gjuhën Angleze. Lidhur me rastin e paraqitur në këtë tender, AK me datë 04.01.2020 ka marrë interpretim nga KRPP-ja, Po i njëjti interpretim Ligjor edhe nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik te INFORMACIONE / PYETJE TË SHPESHTA, lidhur me këto raste (pyetja dhe përgjigjja 66) në mes tjerash ka dhënë opinionin si vijon:

Për veç tenderi, i cili ofron specifikimet teknike në gjuhë tjetër nga ajo e përcaktuar me LPP, duhet të përjashtohet, ndërsa për cilindo dokument tjetër të kërkuar si dëshmi sipas nenit 65-71 të LPP-së, në përputhje me nenin 72 të LPP-së mund të kërkohet nga OE që të dorëzojë një përkthim zyrtar të të njëjtit dokument. Sigurimi i informacionit që mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderit dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive. Meqenëse tenderuesi i rekomanduar për kontrate "GËRLICA - COMPANY" SH. P.K., Babush P.N., Ferizaj, në lidhje me këtë çështje, me dt. 26.11.2019 ka dorëzuar ne OSHP, një parashtrese si sqarim ne lidhje me ketë pretendim, ku kësaj parashtrese ja ka bashkangjitur diplomat) me përkthim origjinal te përkthyer nga përkthyesi gjyqësor z.Afrim Sejdini me dt. 05.06.2017, andaj, me këto dëshmi vërtetohet se AK nuk ka bërë shkelje të neni 13, sepse sqarimet dhe dëshmitë gjatë rivlerësimi janë bërë në pajtueshmëri me nenin 59 pika 2 dhe 72 të LPP-ës pika 2, për vlerësimin e Kërkesave mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, neni 69 i LPP-së. Ndërsa sa i përket pretendimit te OE ankues Konzorciumit KNPSH "PAPENBURG & ADRIANI COMAPNY Sh.p.k & Companya ESKAVATORI Sh.p.k &Best Company Sh.p.k- Ferizaj, se diploma e gjeodetit te OE te rekomanduar për kontrate është e pa nostrifikuar, paneli shqyrtues ashtu siç e ka cekur edhe eksperti shqyrtues sqaron se nostrifikimi i diplomave nuk ka qenë kërkesë e FDT, prandaj sipas nenit 56.3 te LPP, operatoret ekonomik nuk mund te eliminohen për një kërkesë e cila nuk ka qene kërkesë e dosjes s tenderit dhe e njoftimit për kontrate, citojmë nenin 56.3 te LPP-së : Tenderuesi, gjate procedurave te hapura, ose kandidati, gjate procedurave te kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do te diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla ne baza te ndonjë kërkesë ose kriteri qe nuk është i cekur ne njoftimin e kontratës dhe ne dosjen e tenderit. Pas këtyre argumenteve të prezantuara në përgjigjet e pretendimeve të Grupit të operatorëve ekonomik Eskavatori" Sh.p.k.& KNPSH. "PAPENBURG & ADRIANI COMPANY" Sh.p.k. & "Best Company" SH.P.K. Magjis. Ferizaj – Prishtinë, Ferizaj, paneli shqyrtues ashtu sikur ekspertja shqyrtuese vlerëson se AK me të drejtë dhe me arsye e ka kualifikuar të përgjegjshëm dhe e ka shpallur fitues tenderin e tenderuesit "GËRLICA - COMPANY" SH. P.K., Babush P.N., Ferizaj.

Duke pasur parasysh faktet që u cekën më lartë kuptohet që pretdnimi i OE ankues ëshët çështje e gjykuar – Res Judicata, sipas nenit 105 paragrafi 2.16 i LPP-së, sepse ky pretendim ëhstë gjykuar me vendimin e OSHP-së Nr.769/19, 778/19 dhe 792/19 me datë 23.12.2019

Prandaj rezulton se operatori ekonomik ankues në këtë aktivitet të prokurimit është palë pa interes juridik material konform nenit 4 paragrafi 1.26 i LPP-së, përkitazi me nenin 111 paragrafi 1-8 i LPP-së, pasi që në asnjë mënyrë ky OE ankues nuk ka mundur të dëshmojë se shkelja e supozuar i është kërcënuar ti shkaktojë dëme këtij operatori ekonomik dhe njëkohësisht me këto rrethana dhe fakte, i njëjti operator në asnjë variant nuk ka mundur të shpallet fitues i këtij tenderi.

Sa i përket pretendimeve të OE ankues "2A Group & 2T Shpk"-Prishtinë, paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues ishte detyruar me vendimin e OSHP – së Nr. PSH. 769/19, 778/19 dhe 792/19 të datës 23.12.2019 që gjatë rivlerësimit të kërkojë sqarime shtesë në lidhje me kontratat dhe referencat përkatësisht procesverbalet e pranimeve teknike të ofruara nga ky operator ekonomik, pasi që ka pasur paqartësi se i njëjti operator ekonomik a e plotëson kërkesën në lidhje me kapacitetin teknik dhe profesional.

Paneli shqyrtues duke u bazuar në dokumentet që ka pasur në dispozicion sqaron se autoriteti kontraktues me dt.06.04.2020 ka kërkuar nga OE ankues "2A Group & 2T Shpk"-Prishtinë që të bëhet një deklaratë nën betim e cila tregon se marrëveshja e konzorciumit në këtë projekt është valide, të sillet e nënshkruar e vulosur origjinale në formë fizike si dhe në formë të skanuar në email deri më së largu me 09.04.2020 ora 14:00.

Po ashtu ka kërkuar që të bëhet vazhdimi i kontratës së punës për inxhinierin e ndërtimtarisë z. Naim Ahmeti pasi që i ka skaduar kontrata me dt.15.01.2019 edhe kjo të sillet në formë fizike origjinale si dhe ne email në formë të skenuar në email deri më së largu me 09.04.2020 ora 14:00.

Autoriteti kontraktues ka kërkuar sqarime shtesë nga OE ankues edhe për kontratat si në vijim:

Kontrata "Rikonstruimi i rrugës Hani I Hotit Tamare" me nr. Kontrate CËC/ICB/2010/WL-Rec 46 e kontraktuar me dt.11.01.2013, që të sillet marrëveshja midis kompanisë 2T dhe COPRI CONSTRUCTION ENTEPRISES Ë.L.L për nënkontarktim si dhe të ofrohet referenca në emrin 2T që janë kryer punimet sipas projektit duke specifikuar datën:01.01.2014-31.12.2014 si dhe të specifikohet vlera e punëve të kryera për këtë periudhë e cila hynë në trevjeçarin e kërkuar, të sillet origjinal ose në formë fizike, ndërsa me email të dërgohet e skenuar deri me së largu me 09.04.2020 ora 14:00.

Kontrata "Rikonstruksioni i rrugës që lidh rr. Farka me rrugën Elbasani (kontrata e lidhur në vitin 2013) ju lutem të sillni një raport përfundimtar ose referencë sipas datës për punët e kryera gjatë periudhës 01.01.2014-09.2015 duke specifikuar vlerën e punëve të kryera gjatë kësaj periudhe të sillet origjinal ose në formë fizike, ndërsa me email të dërgohet e skenuar deri me së largu me 09.04.2020 ora 14:00.

Kontrata për ndërtimin e Bypasit të Rogozhinës (të sillet një marrëveshje midis kompanisë 2T Shpk me kompaninë IMPRESA PREVEDELLO ISDOROS.R.L për nen kontraktimin tuaj në këtë projekt si dhe të sillet referencë për projektin në fjalë duke specifikuar vlerën dhe periudhën e punimeve, të sillet origjinal ose në formë fizike, ndërsa me email të dërgohet e skenuar deri me së largu me 09.04.2020 ora 14:00.

Kontrata "Rikonstruimi i rrugës Vagarr-Gropaj-Kthesa e Kashari" me nr. Kontrate CËC/ICB/201/ËL-Rec 94 e kontraktuar me dt.11.01.2013, të sillet raporti përfundimtar ose referencë për punët e kryera gjatë periudhës 01.04.2014-07.2015 duke specifikuar vlerën e projektit të realizuar gjatë kësaj periudhe të sillet

origjinal ose në formë fizike, ndërsa me email të dërgohet e skenuar deri me së largu me 09.04.2020 ora 14:00.

Paneli shqyrtues duke u bazuar në shkresat e lëndës sqaron se autoriteti kontraktues fillimisht kishte bërë një kërkesë për interpretim me dt.30.03.2020 tek KRPP se a duhet të kërkohet sqarime shtesë për çështjet e kontratave të punëtorëve, konfirmimin e konzorciumit etj. pasi që projekti ka filluar në vitin 2017, ndërsa me dt01.04.2020 kishte marr përgjigje ku është sqaruar neni 59 dhe 72 paragrafët 1,2,3 i LPP-së se mund të kërkohen sqarime për në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji.

Paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues e ka zbatuar vendimin e OSHP-së PSH.Nr. 769/19, 778/19 dhe 792/19 të dt. 23.12.2019, duke kërkuar sqarime shtesë nga OE ankues, ashtu siç ishte urdhëruar nga paneli shqyrtues ku në vendimin e lartpërmendur ishte cekur se dëshmitë në lidhje me kontratat dhe referencat për periudhën trevjeçare duhet të vërtetohen saktë se a i plotëson ky operator ekonomik sa i përket periudhave të filluara të kontratave dhe periudhave të përfunduara, prandaj duhet të kërkohen sqarime shtesë sipas nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së. Pra AK-ja ka kërkuar sqarime shtesë nga OE ankues "2A Group & 2T Shpk"-Prishtinë, mirëpo i njëjti nuk ka ofruar asnjë sqarime shtesë në lidhje me kërkesën e AK-së, madje në ankesën e tij të dt.14.05.2020 pyetjen e AK-së në lidhje me kontratat dhe referencat e ka quajtur kundërligjore.
Përderisa OE ankues "2A Group & 2T Shpk"-Prishtinë, nuk ka dhënë sqarime dhe nuk është përgjigjur brenda afatit të caktuar nga AK-ja, atëherë nuk ka se si të kuptohet ndryshe, përveç se ky operator ekonomik nuk ka shprehur interesim për të vazhduar më tutje në këtë aktivitet të prokurimit, sepse janë kërkuar sqarime konkrete për të dëshmuar vlefshmërinë dhe përgjegjshmërinë e ofertës së tij. Prandaj rezulton se operatori ekonomik ankues në këtë aktivitet të prokurimit është palë pa interes juridik material konform nenit 4 paragrafi 1.26 i LPP-së, përkitazi me nenin 111 paragrafi 1-8 i LPP-së, pasi që në asnjë mënyrë ky OE ankues nuk ka mundur të dëshmojë se shkelja e supozuar i është kërcënuar ti shkaktojë dëme këtij operatori ekonomik dhe njëkohësisht me këto rrethana dhe fakte, i njëjti operator në asnjë variant nuk ka mundur të shpallet fitues i këtij tenderi, madje i njëjti operator ekonomik nuk ka shpreh as interesim për tu përgjigjur në pyetjet e autoritetit kontraktues.

Paneli shqyrtues konstaton se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët, konform nenit 60 të LPP-së.
Paneli shqyrtues sqaron se autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së, ndërsa autoriteti kontraktues në këtë rast

ka vepruar konform këtij neni. Gjithashtu paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit ka marr parasysh dhe ka vepruar duke pasur në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

z. Blerim DINA

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK- Komuna Ferizaj;

1x1 OE-"PAPERBURG&ADRIANI COMPANY" Sh.p.k & "ESKAVATORI" Sh.p.k & "Best Company" Sh.p.k-Ferizaj;

1x1 OE "2A Group & 2T Shpk"-Prishtinë;

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.